



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.9, datë 17/07/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “ANORIA” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS KM 6, KASHAR, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “ANORIA” sh.p.k, “Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme, me vendndodhje, Autostrada Tiranë-Durrës Km 6, Kashar, Tiranë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

- X= 478443.28;      Y= 4580399.55;      Z= 56 m.

Prurja e ujit të kërkuar: Q= 0.2 l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 30 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 25 m

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

---

-X= 478410.38;      Y= 4580446.65;      Z= 55.5 m.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

